

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 10 pika 1.1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144, si dhe nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **04.04.2013**, mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME PËR MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME - AKADEMISË SË KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

Neni 1

Me këtë vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë pjesë nga parcela P-70202016-02358-1, e cila evidentohet në certifikatën e pronësisë UL-70202016-00045, si dhe pjesë nga parcela P-70202016-02358-5 evidentuar në certifikatën pronësore UL-70202016-03596, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në sipërfaqe të përgjithshme prej: 00.40.00 ha.

Neni 2

Paluajtshmëria e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin pa kompensim në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) viteve, për Ministrinë e Punëve të Brendshme – Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, për ndërtimin e objektit të Fakultetit për Shkenca të Sigurisë Publike dhe konviktit të studentëve.

Neni 3

Nëse brenda afatit prej 3 (tre) viteve nga dita e miratimit nuk fillon investimi, atëherë ndërpritet (humbet) e drejta për shfrytëzimin e parcelës sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.


Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 Nr.276/10, dt.30.12.2010 për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim.





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 10 pika 1.1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, si dhe nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **04.04.2013**, miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË GJYKATËS KOMUNALE TË VUSHTRRISË

Neni 1

Me këtë vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë pjesa nga parcela nr. P-70202016-02358-1, e cila evidentohet në certifikatën e pronësisë UL-70202016-00045, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, si dhe pjesa nga parcela P-70202016-02358-5 e cila evidentohet në certifikatën e pronësisë nr. UL-70202016-3596 pronë e Komunës së Vushtrrisë e cila përfshin sipërfaqen e përgjithshme prej:00.15.00 ha.

Neni 2

Paluajtshmëria e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ndërtimin e Gjykatës Komunale të Vushtrrisë në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) viteve, kurse Këshilli Gjyqësor i Kosovës obligohet që si kompensim për parcelën (e përmendur në nenin 1 të këtij vendimi) t'ia bart në pronësi Komunës së Vushtrrisë parcelën kadastrale dhe objektin aktual të Gjykatës Komunale në Vushtrri.

Neni 3

Nëse brenda afatit prej 3 (tre) viteve nga dita e miratimit nuk fillon investimi, atëherë ndërpritet (humbet) e drejta për shfrytëzimin e parcelës sipas nenit 1 të këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimi në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.





REPUBLICA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО
KOMUNA E VUSHTRRISË-ОПШТИНА ВУЧИТРН

01 Nr./Br 68/13

Nr. i fq./Br. st -1-

Data: / Datum 04.04.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12 "d" dhe 82.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 41 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të rekomandimit dt. 31.01.2013 të Komisionit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Financave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të komunave, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **04.04.2013**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIM TË RREGULLORES PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA
KOMUNALE

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjopa Komunale 01Nr.330/12, dt. 27.12.2012, si në vijim: hiqen tarifat e nivelit dytësor të përcaktuara nga pika 1.42 deri 1.86 e rregullores në fjalë.

Neni 2

Ky vendim është pjesë përbërëse e rregullores, e cila ndryshohet dhe i bashkëngjitet në shtojcë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Vushtrri.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

DI Nr. / Br. 69/13

Nr. i fq. / Br. st. -1-

Data: / Datum 04.04.2013

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12 "d" dhe 82.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 41 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të rekomandimit dt. 31.01.2013 të Komisionit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Financave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të komunave, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **04.04.2013**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIM TË RREGULLORES PËR TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA
KOMUNALE

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale 01Nr.330/12, dt. 27.12.2012, si në vijim: hiqet paragrafi 7.5 i nenit 7 të rregullores në fjalë.

Neni 2

Ky vendim është pjesë përbërëse e rregullores, e cila ndryshohet dhe i bashkëngjitet në shtojcë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Vushtrri.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN

01 Nr. / Br 70/13

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 04.04.2013

VUSHTRRI - VUCITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 40 "l" dhe 41 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr.269/12, dt.27.09.2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: **04.04.2013**, mori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË DHE
NXËNËS PËR VITIN SHKOLLOR 2012/2013

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni prej 5 (pesë) anëtarëve për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës për vitin shkollor 2012/2013, në këtë përbërje:

1. Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim;
2. Selim Rustemi, anëtar i kuvendit (PDK);
3. Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit (PDK);
4. Vlora Qirezi, anëtare e kuvendit (LDK);
5. Qazim Azemi, anëtar i kuvendit (AAK).

Neni 2

Bursat për studentë dhe nxënës ndahen në bazë të kriterëve të caktuara në konkursin e datës 21.03.2013, të publikuar nga Drejtoria për Arsim.

Neni 3

Komisioni për ndarje të bursave gjatë punës së tij duhet t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe t'i respektojë kushtet dhe kriteret e parapara me konkursin e publikuar.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe komisioni për ndarjen e bursave.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimi në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa

